



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.05.2023

Nr: 118

Ora: 13:45

VENDIM

**PËR PUSHIMIN E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 62, DATË 19.05.2023 TË DEPOZITUAR
NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA E UNITETIT KOMBËTAR”**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar”, përfaqësuar nga z. Argjontjano Noka dhe zj. Grejida Muça, me autorizim

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 125, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 12 dhe nr. 108, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 13, bashkia Lezhë “Për miratimin



e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të bashkisë Lezhë”

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar me nr. 62 regj., datë 17.05.2023 me anë të së cilës kundërshton vendimin nr. 125, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 12 dhe vendimin nr. 108, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 13, bashkia Lezhë “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të bashkisë Lezhë”.
2. Në seancën e vlerësimit paraprak, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore është paraqitur me të meta pasi nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor. Konkretisht kërkesa ankimore nuk është e shoqëruar nga vendimi i KZAZ që kundërshtohet, provat mbi të cilat mbështetet kërkitimi si dhe një përshkrim më i detajuar i fakteve dhe rrethanave konkrete në interpretim të provave. Në këto kushte, me vendimin e ndërmjetëm nr. 117, datë 18.05.2023, KAS vendosi kthimin e kërkesës ankimore për plotësim të elementeve të formës dhe të përmbajtjes, duke i lënë ankimuesit një afat 24 orë dhe duke caktuar seancën paraprake më datë 19.05.2023, ora 13:40.

Në përfundim të afatit të caktuar me anë të vendimit 117, datë 18.05.2023, në seancën e datës 19.05.2023, ora 13:45, pas relativitetit të anëtarit z. Elvis Çefa,

KAS-i konstaton se:

1. Kërkesa ankimore objekt i këtij procedimi është pa objekt, pasi pala ankimuese, jo për fajin e saj, nuk ka mundur të paraqesë vendimin përfundimtar “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve” për bashkinë Lezhë, rezultati i të cilës ankimohet nëpërmjet këtij ankimimi.
2. Duke qenë se territori i njësisë të qeverisjes vendore bashkia Lezhë, është i ndarë në dy Zona Administrimi Zgjedhor, konkretisht në ZAZ me nr. 12 dhe në ZAZ nr. 13, në këtë rast, në referim të nenit 123 të Kodit Zgjedhor vendimi “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve” merret nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga secila KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.
3. Në këto kushte, vetëm pasi Komisioneri të shprehet me vendim mbi miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Lezhë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, subjekteve zgjedhore i lind e drejta që të ankimojnë vendimin në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.
4. Në të tilla rrethana, objekti për të cilin ka nisur në KAS procedimi për shqyrtimin e Kërkesa Ankimore nr. 62, datë 19.5.2023 me objekt: Kundërshtim i vendimit nr. 125, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 12 dhe nr. 108, datë 17.05.2023 të KZAZ nr. 13, bashkia Lezhë “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të bashkisë Lezhë” është i pamundur të vazhdojë, dhe për këtë arsye ky fakt, bazuar në nenin 143 të Kodit Zgjedhor passjell detyrimin e KAS për pushimin e shqyrtimit të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja “c” dhe në nenin 143, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.05.2023 Nr: 118
Ora: 13:45



“Për pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 62, datë 19.05.2023 të depozituar nga subjekti zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar”

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 62, datë 19.05.2023 të subjektit zgjedhor “Partia e Unitetit Kombëtar”.
2. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall sot më datë 19.05.2023.

Elvis	ÇEFA	- Relator
Elvin	LAKO	- Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	- Anëtar
Koli	BELE	- Anëtar